



Shoqata e të Verbërve të Malit të Zi

REKOMANDIME PËR AVANCIMIN E LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Podgoricë, shtator 2023



Ovaj projekat finansira
Evropska unija



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education



BOTUESI:

Goran Macanoviq, Shoqata e të Verbërve të Malit të Zi

AUTORI:

Grupi i punës

PËRGATITJA DHE DIZAJNI:

Shtypshkronja LAPIS

PRINTIMI:

Shtypshkronja LAPIS

TIRAZHI:

30 copë

Rekomandimet janë përpiluar në kuadër të projektit “Zgjidhi me zgjedh” që realizohet

nga Shoqata e të Verbërve të Malit të Zi. Projekti është mbështetur përmes programit “OSHC në Mal të Zi – nga shërbimet bazë deri tek formimi i politikave – M BASE”, projekti ky që zbatohet nga Qendra për Edukim Qytetar (CGO), Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), Qendra për mbrojtje dhe studim të shpendëve të Malit të Zi (CZIP) dhe rrjeti Politikon.

Projekti financohet nga Bashkimi Evropian, bashkëfinancohet nga Ministria e Administratës Publike. Përmbajtja e këtyre rekomandimeve është përgjegjësia ekskluzive e Shoqatës së të Verbërve të Malit të Zi dhe nuk i pasqyron doemos qëndrimet e CGO, Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Administratës Publike.



Ovaj projektat finansira
Evropska unija



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education



PËRMBAJTJA:

SHKURTESAT:.....	4
VËREJTJE HYRËSE – NEVOJA PËR REFORMËN E LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR.....	5
KUADRI LIGJOR	8
AUTORITETET PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE.....	13
REKOMANDIME PËR AVANCIMIN E LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.....	14
1. DISPOZITAT THEMELORE.....	14
2. E DREJTA E VOTËS	15
3. AUTORITETET PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE	15
4. PROPOZIMI DHE PËRCAKTIMI I LISTAVE ZGJEDHORE.....	18
5. PARAQITJA E PARASHTRUESVE/-ËVE TË LISTAVE ZGJEDHORE DHE KANDIDATËVE/-EVE NGA LISTAT ZGJEDHORE	19
6. ZBATIMI I ZGJEDHJEVE.....	19
7. PËRCAKTIMI DHE PUBLIKIMI I REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE	22
8. MBROJTJA E TË DREJTËS SË VOTËS	23
9. VËZHGESIT/-ET E ZGJEDHJEVE	23
10. DISPOZITAT PENALE.....	24
PËRFUNDIM	24
PËR SHOQATËN E TË VERBËRVE TË MALIT TË ZI.....	25

SHKURTESAT:

VV - vendvotimi

KZ - komisioni zgjedhor

VMK – votuesi/-ja me aftësi të kufizuara

KSHZ - Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

KKZ - Komisioni Komunal i Zgjedhjeve

PDP - personat me dëmtim të të pamurit

PAK - personat me aftësi të kufizuara

SHVMZ - Shoqata e të Verbërve të Malit të Zi

VËREJTJE HYRËSE – NEVOJA PËR REFORMËN E LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR

Personat me aftësi të kufizuara (PAK) në të gjithë Malin e Zi ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar. Megjithatë, lind pyetja nëse e drejta e tyre e votës mund të ushtrohet sipas standardeve bazë ndërkombëtare të votimit dhe legjislacionit vendas në drejtim të votimit të pavarur dhe të fshehtë?

Kushtetuta e Malit të Zi garanton të drejtat e përgjithshme dhe të barabarta të votës dhe fshehtësinë e votës për të gjithë qytetarët e tij. E drejta për jetën politike dhe publike e komunitetit PAK rregullohet me akte të shumta pozitive ligjore që Mali i Zi ka miratuar ose ratifikuar, dhe përfshin të drejtat aktive dhe pasive të votimit të PAK.

PAK, qytetarët/-et e Malit të Zi, marrin pjesë në mënyrë të pamjaftueshme dhe rrallëherë janë të përfaqësuar në jetën politike. Sa i përket të drejtave aktive të votës në Mal të Zi, ende nuk janë siguruar kushte të përshtatshme për votim të pavarur dhe të fshehtë të kësaj popullate.

Tradicionalisht, PAK nuk janë ende të pavarur gjatë votimit, pasi ata shpesh varen nga persona të tjerë, ose nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar në vetë qendrën e votimit, dhe për këtë arsye e kanë të kufizuar marrjen e vendimit në mënyrë të pavarur. PAK mbështeten nga anëtarët e familjes të cilët shpeshherë ndikojnë në vullnetin e tyre, duke cenuar kështu parimet e pavarësisë dhe fshehtësisë gjatë votimit.

Ndonëse të përfshirë në mënyrë të pamjaftueshme në sferat e jetës politike dhe publike, PAK shfaqin interes të madh për vetë aktin e votimit në zgjedhje. Ajo që pengon pjesëmarrjen më aktive të PAK janë, në fakt, paragjykimet e shoqërisë, si dhe pengesat e shumta fizike dhe jo materiale që i mbajnë ata brenda shtëpive të tyre.

Ushtrimi i së drejtës së votës për PAK në Mal të Zi nuk është i mundur në mënyrë dinjitoze dhe të barabartë. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e thekson se shtetet nënshkruese ua garantojnë PAK të drejtat e tyre politike dhe mundësinë për t'i gëzuar këto të drejta në bazë të barazisë me të tjerët, kështu që Mali i Zi, duke e ratifikuar këtë Konventë, është detyruar që t'ua mundësojë PAK dhe t'i krijojë kushtet për gëzimin aktiv dhe pasiv të së drejtës së votës¹. Megjithatë, situata reale nuk tregon se aktorët dhe institucionet që marrin pjesë në procesin zgjedhor ndërmarrin hapa dhe ua mundësojnë PAK të votojnë, por edhe të zgjidhen.

Qytetarët/-et mund të ndikojnë në proceset politike duke votuar, duke u anëtarësuar në parti politike dhe duke u kandiduar për poste, por në lidhje me këto aspirata, PAK ballafaqohen me pengesa të shumta. Është e drejtë njerëzore e çdo PAK të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në jetën politike dhe publike në baza të barabarta me të tjerët.

¹ Neni 29 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Kur flitet për PAK, shpesh theksohet se në realitetin tonë shoqëror ata janë mjaft pasivë, në një formë të izolimit brenda shtëpive apo institucioneve. Për shkak të paaksesueshmërisë së mjedisit, të procedurave dhe informacionit, PAK nuk i gëzojnë kushtet që do tua mundësonin pjesëmarrjen më aktive në proceset vendimmarrëse, zgjedhjen e përfaqësuesve, pjesëmarrjen në debate e të ngjashme. Për të qenë në gjendje të monitorojnë dhe të japin kontributin e vetë si në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ashtu edhe në procesin e anëtarësimit në BE, PAK duhet t'i kenë informacionet, programet dhe vendvotimet (VV) të aksesueshme. Në lidhje me këtë, është e nevojshme që të gjithë aktorët të përfshihen në zbatimin e rregulloreve tashmë ekzistuese, por edhe në avancimin e tyre.

Deri në vitin 2014, PAK, nëse kanë votuar në zgjedhje, këtë e kanë bërë me ndihmën e asistentëve dhe duke votuar nga shtëpia. Që nga viti 2013, kur janë pilotuar për herë të parë në zgjedhjet presidenciale, personat me shikim të dëmtuar (PAK) kanë pasur mundësinë të votojnë duke përdorur një shabllon votimi. Përcaktimi dhe aplikimi i shabllonit për votim të pavarur dhe të fshehtë të PDP përmes Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve të vitit 2014 është diçka shumë e lavdërueshme, e avancuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikën ligjore të vendeve të zhvilluara.

Megjithatë, gjatë zgjedhjeve presidenciale në Mal të Zi më 15 prill 2018, aplikimi i shabllonit të përmendur tregoi mangësi serioze, të cilat kërkonin përmirësime.²

Në përputhje me legjislacionin ekzistues dhe detyrimet që Mali i Zi i ka ndërmarrë ndërkombëtarisht, dhe me qëllim të avancimit të kushteve për pjesëmarrjen e pavarur, të fshehtë dhe dinjitoze të PAK në procesin zgjedhor, kryesisht nëpërmjet aksesit tek VV, procedurave dhe materialeve të votimit, Shoqata e të Rinjve me Aftësi të Kufizuara të Malit të Zi dhe Shoqata e të Verbërve të Malit të Zi (SHVMZ), në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Mal të Zi, zhvilluan Udhëzimet³ të cilat u përdorën për të inicuar ndryshime në aktet nënligjore të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), të cilat janë të detyrueshme për të gjitha komisionet komunale zgjedhore (KKZ) në të gjitha ciklet zgjedhore: lokale, presidenciale, parlamentare.

Përkundër rregullimeve ligjore relativisht adekuate dhe nismave të vazhdueshme që janë drejtuar për përmbushjen e secilit proces zgjedhor, kushtet për PAK nuk kanë qenë adekuate as gjatë zgjedhjeve presidenciale të mbajtura më datën 19 mars 2023. Situata në VV ishte kryesisht e pakënaqshme⁴, gjë që pasqyrohet në faktin se një numër i madh i VV, edhe pse ndodhen në objekte publike dhe objekte në përdorim publik, janë krejtësisht të paaksesueshme (shembull: mungesa e hapësirave për parkim, shkallët në hyrje, zona e ngushtë e hyrjes, dyer të dyfishta me një krah të mbyllur). Sa i përket brendësisë së VV, edhe pse janë siguruar nga KSHZ, në të gjitha VV nuk ka pasur shabllone për votim. Për më tepër, kutitë e votimit nuk ishin vendosur në një lartësi më të ulët, kështu që disa kategori votuesish me aftësi të kufizuara (VAK) nuk mund të fusnin në kuti në mënyrë të pavarur fletën e votimit dhe në këtë mënyrë të siguronin fshehtësinë e votës, dhe në një numër të madh të VV nuk kishte asnjë raft më të ulët në kabinën e votimit, as dysheme të veçantë për lëvizjen e pavarur të PSHD në VV.

² Më shumë detaje në: <https://ss-cg.org/?p=4028>.

³ <https://disabilityinfo.me/ljudska-prava/item/1354-smjernice-za-unapredjenje-pristupacnosti-izbornog-procesa-za-osobe-s-invaliditetom-osi>

⁴ Më shumë detaje në: <https://www.osce.org/odihr/elections/montenegro/537026>.

Si sqarim, disa anëtarë të këshillave zgjedhore (KZ) deklaruan se në VV nuk ka PAK dhe se ata kryesisht votojnë me letra dhe/ose se do t'u ndihmojnë nëse paraqiten. Meqenëse nuk ekziston një regjistër qendror i PAK, është interesante që anëtarët e VV pretendojnë se dinë diçka për të cilën shteti i Malit të Zi nuk ka evidenca.

Gjatë ditës së zgjedhjeve, në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të mbajtura më parë, më datën 11 qershor 2023, SHVMZ për herë të parë ka monitoruar në mënyrë sistematike aksesueshmërinë e VV në ditën e zgjedhjeve në të tre rajonet e Malit të Zi. Pesëdhjetë (50) vëzhgues/-e të lëvizshëm/-me vizituan 505 vendvotime në 20 komuna me qëllim të monitorimit të zbatimit të procesit zgjedhor në lidhje me aksesin e PAK dhe materialeve zgjedhore për PAK. Monitorimi u krye në pesë kategori, përkatësisht: mjedisi, qasja, hapësira hyrëse e VV, puna e komisionit zgjedhor (KZ) dhe rregullimi i dhomës së VV në lidhje me aksesin fizik dhe materialet zgjedhore. Rezultatet kanë treguar se komunitetit të PAK nuk u është mundësuar që të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në mënyrë dinjitoze, të pavarur dhe të fshehtë gjatë ditës së zgjedhjeve.⁵

Edhe pse KSHZ-ja⁶ ka sjellë dhe ka miratuar ndryshime që obligojnë të gjitha KKZ-të të sigurojnë pavarësinë dhe fshehtësinë e votimit të PAK, sipas konstatimeve të dala nga procesi i vëzhgimit, kjo nuk ka ndodhur.

Duke marrë parasysh numrin e konsiderueshëm të VV ku mungonin elementët e aksesueshmërisë, si: shiritat e vendosur në mënyrë të rregullt, shabllonet e votimit në tavolina dhe broshurat në shkrimin Braille për informacion, raftet e poshtme në kabinat, kutitë e votimit të vendosura më poshtë, mund të përfundohet se edhe ky proces zgjedhor nuk i lejoi të gjithë VI të ushtrojnë të drejtën e votës në mënyrë dinjitoze, të pavarur dhe të fshehtë.⁷

Arsyetimi për krijimin e rekomandimeve rrjedh nga një situatë e pafavorshme për qytetarët/-et me aftësi të kufizuara, që konkretisht pasqyrohet në realizimin e të drejtës për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe të hapur në proceset zgjedhore. Kur flitet për PAK, kryesisht vihet re dhe mendohet për të drejtën e PAK për të zgjedhur, por jo për t'u zgjedhur. Rekomandimet kanë për qëllim përmirësimin e situatës aktuale dhe mundësimin e pjesëmarrjes së PAK, si në proceset reformuese ashtu edhe në proceset vendimmarrëse, dhe në fund të fundit pjesëmarrjen në evropianizimin e shoqërisë.

Demokracia pjesëmarrëse, që mundëson mbrojtjen e interesave të qytetarëve/-eve, është një proces i paimagjinueshëm nëse çon në diskriminim dhe pabarazi. Monitorimi, avancimi i politikave publike, transparenca, përgjegjësia e autoriteteve si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë vendor nuk i lejojnë PAK të marrin pjesë në mënyrë të barabartë, në baza të barabarta, në raport me qytetarët/-et e tjerë. Të gjitha sa më sipër çojnë PAK në një ndjenjë më të fortë pakënaqësie, pabarazie, përjashtimi, në vend të përfshirjes. Avancimi i situatës në fushën e legjislacionit zgjedhor është parakusht për realizimin e të drejtave dhe pjesëmarrjen e barabartë të PAK.

⁵ <https://ss-cg.org/?p=4343>

⁶ <https://dik.co.me/obezbijedeni-uslovi-za-samostalno-i-tajno-glasanje-osoba-s-invaliditetom/>

⁷ <https://ss-cg.org/>

KUADRI LIGJOR

E drejta e komunitetit PAK për t'u përfshirë në jetën politike dhe publike rregullohet nga shumë dokumente ligjore pozitive që Mali i Zi ka miratuar ose ratifikuar, dhe përfshin të drejtat e votës aktive dhe pasive të PAK.

Kushtetuta e Malit të Zi thotë se Mali i Zi është një shtet i pavarur dhe sovran, me një formë qeverisjeje republikane dhe një shtet civil, demokratik, ekologjik dhe i së drejtës sociale, i bazuar në shtetin e së drejtës.⁸ Bartësi i sovranitetit është qytetari që ka nënshtetësi malazeze dhe që e ushtron pushtetin drejtpërdrejt dhe nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë të lirshme.⁹

Mali i Zi garanton dhe mbron të drejtat dhe liritë, të cilat janë të pacenueshme dhe secili është i detyruar të respektojë të drejtat dhe liritë e të tjerëve.¹⁰ Ndalohej çdo diskriminim direkt ose indirekt, mbi çfarëdo baze. Rregulloret dhe vendosja e masave të veçanta që synojnë krijimin e kushteve për arritjen e barazisë kombëtare, gjinore dhe të përgjithshme dhe mbrojtjen e personave që janë në pozitë të pabarabartë mbi asnjë bazë nuk do të konsiderohen si diskriminim.¹¹ Të drejtat dhe liritë ushtrohen në bazë të Kushtetutës dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të konfirmuara. Të gjithë janë të barabartë para ligjit, pavarësisht nga ndonjë veçori apo karakteristikë personale.¹² Të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur e ka shtetasi i Malit të Zi që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka jetuar në Mal të Zi të paktën dy vjet. E drejta e votës ushtrohet në zgjedhje, është e përgjithshme dhe e barabartë. Zgjedhjet janë të lira dhe të drejtpërdrejta, dhe votimi është i fshehtë.¹³

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹⁴ përcakton në nenin 14 se gëzimi i të drejtave dhe lirive sigurohet pa diskriminim mbi asnjë bazë, siç janë: gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, feja, opinionet politike ose të tjera, origjina kombëtare ose shoqërore, lidhja me një pakicë kombëtare, pasuria, lindja ose statusi tjetër. Protokolli numër 12 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore përcakton me nenin 1 se askush nuk mund të diskriminohet nga organet publike për asnjë nga arsyet e sipërpërmendura.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të cilën Mali i Zi e ka ratifikuar në vitin 2009¹⁵, merret me të gjitha segmentet e jetës së PAK. Konventa i detyron shtetet nënshkruese të njohin se të gjithë personat janë të barabarta përpara ligjit dhe kanë të drejtën e mbrojtjes së barabartë para ligjit dhe se i gëzojnë përfitimet e barabarta që i ofron ligji, pa asnjë diskriminim. Ajo, po ashtu, e ndalon çdo diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar dhe garanton mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive për të gjithë PAK kundër diskriminimit mbi çdo bazë. Për të promovuar barazinë dhe për të eliminuar diskriminimin, Shtetet nënshkruese duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e duhura për të siguruar adaptime të arsyeshme¹⁶.

⁸Neni 1 i Kushtetutës së Malit të Zi

⁹Po aty, Neni 2

¹⁰Po aty, Neni 6

¹¹Po aty, Neni 8

¹²Po aty, Neni 17

¹³Po aty, Neni 45

¹⁴<https://www.ombudsman.co.me/Propisi.html>

¹⁵Ligji për Ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara me Protokollin Fakultativ "Gazeta Zyrtare e MZ" nr. 02/09 nga 27.7.2009.

¹⁶Neni 5 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Konventa thotë se shtetet nënshkruese, përfshirë edhe Malin e Zi, **u garantojnë PAK të drejtat e tyre politike dhe mundësinë për t'i gëzuar këto të drejta në bazë të barazisë me të tjerët** ¹⁷. Prandaj, Mali i Zi mori përsipër që të:

(a) sigurojë që PAK të mund të arrijnë pjesëmarrje efektive dhe të plotë në jetën politike dhe publike në bazë të barazisë me të tjerët, drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht, duke përfshirë të drejtën dhe mundësinë e qytetarëve me aftësi të kufizuara për të votuar, për t'u zgjedhur, mes tjerash përmes:

(i) Sigurimit që procedurat zgjedhore, vendvotimet dhe materialet të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe lehtësisht të kuptueshme;

(ii) Mbrojtjes së të drejtës së qytetarëve me aftësi të kufizuara për të votuar me votim të fshehtë në zgjedhje dhe referendume pa frikësime, me mundësi për t'u kandiduar, për të ushtruar në mënyrë efektive mandatin e tyre dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive ndihmëse dhe të reja kur është e përshtatshme;

(iii) Garantimit të shprehjes së vullnetit të lirë të PAK si votuesve dhe për rrjedhojë, kur është e nevojshme, duke lejuar ofrimin e ndihmës në votim për qytetarët me aftësi të kufizuara me kërkesën e tyre dhe nga personat që ata zgjedhin;

(b) Promovojë në mënyrë aktive një mjedis në të cilin PAK, pa diskriminim dhe në bazë të barazisë me të tjerët, do të jenë në gjendje të arrijnë plotësisht dhe pjesëmarrjen efektive në menaxhimin e çështjeve publike dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së këtyre personave në çështjet publike, duke përfshirë:

(i) Pjesëmarrjen në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën politike dhe publike të vendit dhe në aktivitetet dhe menaxhimin e partive politike

(ii) Krijimin e organizatave të PAK dhe anëtarësimin në organizata të tilla që do të përfaqësojnë PAK në nivelin ndërkombëtar, kombëtar, rajonal dhe lokal.

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Shyqrtimet Përfundimtare në lidhje me Raportin Fillestar të Malit të Zi për zbatimin e Konventës¹⁸ ka theksuar me shqetësim se disa pengesa fizike dhe informative ende ekzistojnë në procesin zgjedhor. Komiteti ka rekomanduar që Mali i Zi të ndryshojë ligjet dhe rregullat e procedurës zgjedhore me qëllim që: (a) t'u sigurojë të gjithë PAK të drejtën për të votuar dhe për t'u kandiduar në zgjedhje; dhe (b) Të sigurojë akses fizik të papenguar në votim, të sigurojë mekanizma për të garantuar fshehtësinë e votimit pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar dhe disponueshmëria e materialeve të tjera zgjedhore, siç janë informacioni në formate të aksesueshme në përputhje me Komentin e Përgjithshëm të Komisionit nr. 2 mbi aksesueshmërinë.

¹⁷Po aty, 29

¹⁸Diskutimet përfundimtare të Komitetit (Përkthimi i Shoqatës së të Rinjve me Aftësi të Kufizuara të Malit të Zi)

Vendet anëtare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) kanë zotuar në vitin 1991, me **Dokumentin e Moskës**¹⁹ se do të ndërmarrin hapa për të ofruar mundësi të barabarta për PAK në mënyrë që të marrin pjesë plotësisht në jetën e shoqërisë në të cilën jetojnë, si dhe të promovojnë pjesëmarrjen e PAK në vendimmarrje për të gjitha temat e interesit të tyre.

Ligji për Ndalimin e Diskriminimit²⁰ përcakton se çdo formë e diskriminimit, mbi çfarëdo baze, është e ndaluar. Diskriminim, sipas këtij ligji, është çdo dallim juridik ose faktik ose trajtim i pabarabartë, d.m.th. mostrajtimi i një personi ose një grupi personash në raport me persona të tjerë, si dhe përjashtimi, kufizimi ose dhënia e përparësisë një personi në raport me personat e tjerë që bazohet në një nga cilësitë personale, ndër të cilat është edhe aftësia e kufizuar.²¹

Ligji për Ndalimin e Diskriminimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara²² *si lex specialis, nën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar në fushën e jetës politike dhe publike nënkupton:*

1. mohimin, kufizimin ose vështirësimin e ushtrimit të së drejtës së votës ndaj një personi ose një grupi personash me aftësi të kufizuara përsa i përket rregulloreve që rregullojnë zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve;
2. mohimin e së drejtës për të votuar në mënyrë të pavarur ose për të votuar me ndihmën e një asistenti të një personi ose të një grupi personash me aftësi të kufizuara, me kërkesë dhe me zgjedhjen e një personi ose grupi personash me aftësi të kufizuara;
3. ndalimin, kufizimin ose pengimin e aksesit, lëvizjes, qëndrimit dhe punës në ambientet e partive politike,
4. mohimin ose kufizimin e së drejtës për t'u kandiduar, emëruar dhe zgjedhur në funksion publik të një personi me aftësi të kufizuara nëse këto të drejta nuk u mohohen ose kufizohen personave të tjerë në situatë e njëjtë ose të ngjashme;
5. mosndërmarrja dhe moszbatimi i rregulloreve dhe masave të autoriteteve nga neni 5 paragrafi 1 i këtij ligji për krijimin e kushteve për pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e funksioneve publike;
6. refuzimin e kërkesave dhe përcaktimin e kushteve të veçanta për anëtarësimin e personave apo grupeve të personave me aftësi të kufizuara në organizata joqeveritare; dhe
7. mohimin ose kufizimin e së drejtës e të një personi me aftësi të kufizuar për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese të institucioneve publike, organizatave joqeveritare dhe institucioneve të tjera, si dhe për të kryer efektivisht detyrat dhe funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes me ndihmën e teknologjive për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara.²³

Ligji për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve trajton më gjerësisht të drejtat e votës²⁴, dhe në lidhje me përmbajtjen e tij u përpiluan këto Rekomandime.

¹⁹DOKUMENT (osce.org)

²⁰"Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr.46/2010, 18/2014 dhe 042/17.

²¹Neni 2 i Ligjit për Ndalimin e Diskriminimit

përfundimtare të Komitetit (Përkthimi i Shoqatës së të Rinjve me Aftësi të Kufizuara të Malit të Zi)

²²Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr.035/15, 044/15.

²³Neni 25 i Ligjit për Ndalimin e Diskriminimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara

²⁴"Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi", nr. 004/98, 005/98, 017/98, 014/00, 018/00, "Gazeta Zyrtare e Republikës Federale të Jugosllavisë", nr. 073/00, 009/01, 041/02, 046/02, 045/04, 048/06, 056/06, "Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 046/11, 014/14, 047/14, 012/16, 060/17, 010/18, 109/20).

Standardet e aksesueshmërisë së objekteve publike për PAK janë të përcaktuara me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ndërtim të Objekteve, dhe më konkretisht me Rregulloren për Kushtet më të Afërta dhe Mënyrat e Përshtatjes së Objekteve për Qasje dhe Lëvizje të Personave me Lëvizshmëri të Zvogëluar dhe Personave me Aftësi të Kufizuara²⁵. Rregullorja në fjalë përcakton se rampa, ndër të tjera, duhet të ketë një pjerrësi deri në 5%, një gjerësi prej të paktën 120 cm në hapësirën e jashtme, d.m.th të paktën 90 cm në hapësirën e brendshme, një sipërfaqe të fortë të trajtuar kundër rrëshqitjes dhe një gardh me parmakë²⁶. Ashensori duhet të ketë përmasa 110 x 140 cm brenda, një parmak në ashensor në lartësinë 90 cm dhe një njoftim zanor dhe informacion në alfabetin Braille në panelin e kontrollit.²⁷ Zona e hyrjes e objektit duhet të ketë një derë me një fletë me një gjerësi hapësire të dobishme prej të paktën 110/210 cm, ose një derë me dy fletë me një gjerësi hapësire të dobishme prej të paktën 2 x 90/210 cm, e cila hapet nga jashtë ose anash, dhe pragu i derës nuk mund të jetë më i lartë se 2 cm²⁸. Korridoret duhet të kenë një gjerësi prej të paktën 150 cm, dhe të gjitha sipërfaqet e ecjes duhet të jenë në të njëjtin nivel²⁹.

Rregullorja në mënyrë specifike ka të bëjë me rregullimin e kabinës së votimit. Kabina e votimit për personat që përdorin karrocë invalidi duhet të ketë një panel të sipërm të bërë në një lartësi prej jo më shumë se 85 cm, hapësirë të lirë të siguruar në kabinë në diametër prej 150 cm dhe duhet të jetë më afër hyrjes në zonë dhe/ose sallë ku zhvillohet votimi³⁰, dhe nga dera e hyrjes së objektit deri në kabinën e votimit për personat me të pamurit e dëmtuar duhet të vendoset një vijë drejtuese taktile me gjerësi të paktën 40 cm me brazda në drejtimin drejtues. Nëse në objekt ndodhen tre ose më shumë kabina votimi të të njëjtit lloj, njëra prej tyre duhet të plotësojë kërkesat e aksesueshmërisë³¹.

Vend parkimi duhet të jetë më së afërmi hyrjes së aksesueshme të objektit dhe duhet të jetë 370 x 500 cm për një automjet dhe 590 x 500 cm për dy automjete.³² Në parkingun publik dhe në garazhin publik, si dhe në afërsi të objektit sigurohen 5% të hapësirave të aksesueshme të parkimit në raport me numrin total të parkingjeve (të paktën një).³³

KSHZ në seancën e mbajtur më datë 23 mars 2022³⁴ ka shqyrtuar dhe miratuar nismat e SHVMZ dhe Shoqatës së të Rinjve me Aftësi të Kufizuara të Malit të Zi, ka ndryshuar Rregullat për përcaktimin dhe organizimin e qendrave të votimit³⁵ dhe masat për sigurimin e fshehtësisë së votimit dhe Rregullat për standarde uniforme për materialet zgjedhore³⁶, dhe ka dërguar aktin të gjitha KKZ-ve me të cilin ka urdhëruar që t'i kushtojnë vëmendje dispozitave të ndryshuara, domosdoshmërisë së zbatimit të tyre, për të siguruar kushtet për votim të pavarur dhe të fshehtë të PAK.

²⁵<https://www.gov.me/dokumenta/85a0d4a1-c6f9-438b-8257-00a6493d49ce>

²⁶Neni 11 i Rregullores mbi kushtet dhe metodat më të përafërta të përshtatjes së objekteve për aksesin dhe lëvizjen e personave me lëvizshmëri të zvogëluar dhe personave me aftësi të kufizuara

²⁷Ibidem, neni 13

²⁸Ibidem, neni i 17

²⁹Ibidem, neni 18

³⁰Ibidem, neni 27

³¹Ibidem

³²Ibidem, neni 40

³³Ibidem, neni 51

³⁴<https://dik.co.me/novine-u-izbornom-procesu-koje-se-odnose-na-osobe-sa-invaliditetom/>

³⁵"Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 011/16, 076/17 dhe 033/22

³⁶"Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 015/14, 005/22 dhe 033/22

Në përputhje me këto Rregulla, risitë më domethënëse në procesin zgjedhor kanë të bëjnë me çështjet e mëposhtme:

1. Shablloni i votimit duhet të jetë i punuar prej materiali të përshtatshëm me ngjyrë blu të errët dhe të ndjekë pamjen e fletës së votimit, me unaza metalike, për të garantuar fshehtësinë e votës. Deri më tani, shablloni, i cili normalisht e ndjek pamjen e fletës së votimit, nuk kishte unaza, por vetëm vrima, ndaj pati ankesa se gjatë votimit, në shabllon mbetën shenja stilo-lapsi, gjë që cenonte fshehtësinë e votimit. Duke futur një shabllon të ri me unaza metalike, eliminohet cenimi i fshehtësisë së votës.
2. Në mënyrë që çdo PDP të njihet me përmbajtjen e fletës së votimit, çdo VV duhet të ketë dy fletë votimi në alfabetin Braille. Ato janë pjesë e materialit zgjedhor me karakter informativ. Edhe pse i vetëdijshëm për faktin se shkrimi Braille nuk është i kodifikuar në sistemin ligjor malazez, KSHZ ishte i mendimit se është e nevojshme të bëhet një hap përpara për të avancuar të drejtat e PAK në këtë fushë.
3. Kutia e votimit duhet të vendoset në një sipërfaqe të rrafshët me lartësi jo më shumë se 40 cm në mënyrë që personat me shtat të shkurtër dhe përdoruesit e karrocave të mund ta vendosin në mënyrë të pavarur fletën e votimit në kutinë e votimit. Deri më tani, anëtarët e KZ ulnin kutinë e votimit kur votonte një person me shtat të shkurtër ose një përdorues i karrocës, gjë që kërcënonte fshehtësinë e votimit të VI. KSHZ-ja ka konkluduar se VV duhet të rregullohet në atë mënyrë që të gjithë anëtarët e KZ të kenë pamje të papenguar në kutinë e votimit.
4. Lidhur me rregullimin e VV, KSHZ-ja, në përputhje me kompetencat e tij, ka lëshuar një udhëzim për KKZ që të vendosin shirita etison të kuq të errët brenda VV, të cilat do të lehtësojnë orientimin e PDP në tabelën ku ata marrin fletën e votimit dhe më tej në kabinën e votimit. Përveç sa më sipër, me rastin e përcaktimit të VV, KKZ-ja është i obliguar të kujdeset që ato të përcaktohen në objektet që janë të përshtatura për PAK.

Kuadri ligjor në Mal të Zi garanton kryesisht ushtrimin e papenguar të së drejtës së votës për PAK. Ligji për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve përmban disa norma që lidhen me kushtet për ushtrimin e barabartë të të drejtave aktive të votimit, siç janë: marrja e njoftimit për VV në formatin e kërkuar të qasshëm, votimi me ndihmën e një asistenti të zgjedhur nga vetë VI, votimi nga distanca me letër dhe mundësia e votimit duke përdorur shabllonin e fletëvotimit. Ligji nuk e parasheh formën e shabllonit dhe as materialin nga i cili duhet të punohet, për të siguruar fshehtësinë absolute të votimit, por kjo është e përcaktuar me aktet nënligjore të KSHZ-së. Megjithatë, ligji nuk parashikon detyrimin që VV duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë PAK, që përfshin detyrimin e aksesueshmërisë së rrethit, hapësirës hyrëse dhe lëvizjes së papenguar në vetë VV. Megjithatë, edhe normat që kanë qenë adekuate gjatë dhjetë viteve të fundit, zbatohen në mënyrë jokonsistente nga administrata zgjedhore, gjë që kërkon punë shtesë.

Ligji nuk parashikon profesionalizimin e administratës zgjedhore, që është me rëndësi vendimtare. Anëtarët e KSHZ-së dhe KKZ-së duhet të jenë profesionistë e jo përfaqësues të partive politike, në mënyrë që të fokusohen në avancimin e procesit zgjedhor. Gjithashtu, ligji nuk parashikon dispozita penale për mosveprim, përkatësisht moszbatimin e normave ligjore dhe përfshirja e tyre do të kontribuonte në forcimin e vetëdijes së të gjithë aktorëve në procesin zgjedhor.

AUTORITETET PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

Autoritetet për zhvillimin e zgjedhjeve janë: KSHZ, 25 KKZ (secila vetëqeverisje lokale, kryeqyteti historik dhe kryeqyteti) dhe KZ. Sipas ligjit që aktualisht është në fuqi, vijnë përshkrimet dhe kompetencat.

KSHZ ka një përbërje të përhershme dhe të zgjeruar. Përbërja e përhershme e KSHZ-së përbëhet nga: kryetari/-ja dhe dhjetë anëtarë/-e, ndërsa përbërja e zgjeruar përbëhet nga ka një përfaqësues/-e i/e autorizuar të parashtruesit të listës zgjedhore.

Kryetarin e KSHZ-së e emëron Kuvendi në bazë të konkursit publik. Kryetari aktual i KSHZ-së³⁷ nuk është përfaqësues i asnjë partie politike. Kompetencë e KSHZ-së është përkujdesja për mbarëvajtjen e ligjshme të zgjedhjeve, monitorimi i zbatimit të ligjeve, harmonizimi i punës së KKZ-ve, si dhe mbikëqyrja e punës së tyre dhe vendosja e standardeve unike për materialin zgjedhor. KSHZ ka të faqe të vetë të internetit³⁸ ku i publikon të gjitha aktet dhe të dhënat me rëndësi për zhvillimin e zgjedhjeve, si dhe rezultatet e përkohshme dhe përfundimtare të votimit në secilin VV, faqja kjo që nuk është plotësisht e aksesueshme për përdoruesit/-et me aftësi të kufizuara. Në lidhje me realizimin e veprimeve zgjedhore për zgjedhjet parlamentare, KSHZ-ja është përgjegjëse për prokurimin dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore KKZ-ve, ndër të cilat veçojmë shabllonet e votimit dhe broshurat informative në alfabetin Braille.

KKZ në përbërje të përhershme emërohet nga kuvendi komunal sipas rregullave të përcaktuara³⁹. KKZ-ja përbëhet nga: kryetari dhe katër anëtarë të përhershëm dhe ka një përfaqësues/-e i/e autorizuar i parashtruesit të listës zgjedhore. KKZ-ja përkujdeset dhe organizon përgatitjet teknike për zhvillimin ligjor të zgjedhjeve. Gjithashtu, ato përcaktojnë VV dhe formojnë KZ dhe caktojnë kryetarin/-en dhe anëtarët/-et e KZ për zgjedhjen e këshilltarëve/-eve dhe deputetëve/-eve dhe organizon edukimin (trajnimin) e tyre për procedurat për punën e KZ⁴⁰. KKZ-të përdorin faqen e internetit të KSHZ-së.

³⁷ Neni 32 i Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve

³⁸ <https://dik.co.me/>

³⁹ Neni 23 i Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve

⁴⁰ Po aty, Neni 27

KZ përbëhet nga kryetari/-ja dhe katër anëtarë/-e të përhershëm dhe ka një përfaqësues/-e të autorizuar të parashtruesit të listës zgjedhore⁴¹. Çdo parti politike të përfaqësuar në kuvendin përkatës i takon numri i kryetarëve të KZ në raport me përfaqësimin proporcional në kuvend, kurse VV ku një parti politike do të propozonte përfaqësuesin/-en për kryetar/-e të KZ, KKZ i çarton me short. KZ emërohet për çdo VV jo më vonë se 10 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve. Përgjatë kësaj, me kërkesë të arsyetuar, përbërja e KZ mund të ndryshohet edhe pas skadimit të afatit 10-ditor dhe jo më vonë se 12 orë para hapjes së VV. Kryetari/-ja dhe anëtarët/-et e KZ si dhe përfaqësuesit/-et e autorizuar/-a të parashtruesve të listave zgjedhore, në rast të mungesës ose pamundësisë së tyre, në kryerjen e punëve dhe detyrave të KZ zëvendësohen nga zëvendësit e tyre. KZ drejton drejtpërdrejt procesin e votimit në VV dhe kujdeset për ruajtjen e rendit në VV gjatë votimit dhe cakton nga radhët e vetë katër komisionerë për votim jashtë VV⁴². Rregullat e hollësishme për punën e KZ i rregullon KSHZ-ja.

REKOMANDIME PËR AVANCIMIN E LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Rekomandimet e mëposhtme janë punuar në bazë të Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve që aktualisht është në fuqi, raportet ndërkombëtare⁴³ dhe të organizatave vendase⁴⁴, duke analizuar kuadrin ligjor dhe përvojën e VI⁴⁵.

1.DISPOZITAT THEMELORE

LIGJI TË RREGULLOJË AKSESUESHMËRINË E ZGJEDHJEVE PËR PAK

Neni 1 i Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve parasheh se çfarë rregullohet me të. AKSESUESHMËRIA E ZGJEDHJEVE mungon ndër sa më sipër, megjithëse ligji thotë “...dhe çështje të tjera me rëndësi për organizimin dhe zbatimin e zgjedhjeve”.

Është e nevojshme të theksohet dhe të obligohen të gjithë ata që zbatojnë Ligjin për të rregulluar aksesin në zgjedhje të PAK. Në të njëjtën kohë, aksesueshmëria, si e drejtë dhe si parim i përcaktuar me Konventën e OKB-së, përfshin aksesueshmërinë e mjedisit dhe objekteve fizike, informacionit, komunikimit, teknologjive dhe sistemeve të informacionit dhe komunikimit, shërbimeve dhe trafikut.

⁴¹Po aty, Neni 35

⁴²Po aty, Neni 37

⁴³Raporti i ODIHR

⁴⁴Raportet e Shoqatës së të Verbërve të Malit të Zi, Shoqatës së të Rinjve me Aftësi të Kufizuara të Malit të Zi

⁴⁵Raportet e Misionit të OSBE-së në Mal të Zi, konkluzione nga fokus grupet e mbajtura

VOTUESIT/-ET KANË TË DREJTË TË INFORMOHEN PËRMES MEDIAVE, NE FORMAT TË PËRSHTATSHËM, PËR PROGRAMET DHE AKTIVITETET ZGJEDHORE TË PARASHTRUESVE TË LISTAVE ZGJEDHORE SI DHE TË KANDIDATËVE/-EVE.

Situata aktuale tregon se personat me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara nuk janë të informuar për programet zgjedhore, për shkak të paaksesueshmërisë së informacionit në dispozicion. Mungon interpretimi në gjuhën e shenjave, përshkrimi audio, formati i lehtë për t'u kuptuar, titrat, transkriptet. Të gjitha sa më sipër cenon të drejtën e VI për t'u informuar me kohë dhe saktësi dhe për të marrë një vendim bazuar në informacionin e disponueshem, ashtu si votuesit e tjerë, qytetarët e Malit të Zi.

2. E DREJTA E VOTËS

LIGJI TË RREGULLOJË AKSIONIN AFIRMATIV PËR TË DREJTAT E VOTËS PASIVE TË PAK.

Dispozita aktuale për të drejtën e votës nuk i pengon PAK që të kandidohen në zgjedhje dhe të zgjidhen. Megjithatë, dispozita e përgjithshme nuk është e mjaftueshme për të mundësuar dhe për të inkurajuar kandidaturën e tyre, sepse PAK nuk janë në të njëjtën pozitë me kandidatët pa aftësi të kufizuara, pra nuk kanë mundësi të barabarta për kandidim, kështu që dispozita e përgjithshme nuk mund të sigurojë pjesëmarrjen e tyre në një mënyrë të barabartë me të tjerët. Për shkak të sa më sipër, është e nevojshme të parashikohet një aksion afirmativ për pjesëmarrjen e PAK në zgjedhje, që është në përputhje me Kushtetutën e Malit të Zi.

3. AUTORITETET PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

FAQET E INTERNETIT E TË GJITHA KOMISIONEVE ZGJEDHORE DUHET TË HARMONIZOHEN ME STANDARDET E E-AKSESUESHMËRISË.

Në pjesën që ka të bëjë me transparencën e organit të zbatimit të zgjedhjeve, dhe me qëllim të aksesueshmërisë së barabartë të informacionit për PAK, është e nevojshme të specifikohet detyrimi i disponueshmërisë së informacionit në formate të aksesueshme për PAK, këto që i referohen faqeve të përshtatura të internetit të KSHZ dhe KKZ.

Faqet e internetit të komisioneve zgjedhore duhet të ndjekin standardet e aksesueshmërisë elektronike: standardi teknik ndërkombëtar ISO/IEC 40500:2012 - Udhëzimet e aksesueshmërisë së përmbajtjes në ueb 2.0 - WCAG 2.1, ky që u zhvillua si pjesë e iniciativës së Konsorciumit Ndërkombëtar të Internetit (Eng. W3C WAI - Iniciativat e Përmbajtjes në Ueb) si dhe ato Udhëzime ekzistuese që janë përgatitur në periudhën paraprake nga Ministria e Administratës Publike në bashkëpunim me SHVMZ, dhe Rregullore për standardet e aksesueshmërisë elektronike që është publikuar nga Ministria e Administratës Publike më 21 tetor 2020⁴⁶. Rregullorja përcakton qartë detyrimin që të gjitha komponentët e ekranit të përdoruesit të aplikacionit dhe navigimit të mund të përdoren pa pengesë nga përdoruesit, veçanërisht PAK, dhe që në përmbajtjen e shërbimit të administrimit elektronik mund të qasen me teknologjitë ndihmëse që i përdorin.

Zbatimi i standardeve të aksesueshmërisë elektronike është një detyrim që u mundëson përdoruesve me aftësi të kufizuara të gjejnë, lexojnë dhe ndajnë përmbajtje nga faqet e internetit. Përmbajtja i referohet si vetë faqes së internetit dhe lajmeve, ashtu edhe e-dokumenteve që publikohen në të.

SESSIONET E KSHZ TË NDIQEN ME PËRKTHIM NË GJUHËN E SHENJËVE.

Është e nevojshme që seancat e KSHZ-së të shoqërohen me një përkthim në gjuhën e shenjave, në mënyrë që personat me dëmtime të dëgjimit të kenë akses dhe të disponojnë me informacionin në kohë të duhur dhe në mënyrë të drejt-përdrejtë.

KOMPETENCA E KKZ-VE QË TË PËRCAKTOJNË VEND-VOTIMET E QASSHME PËR PAK PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLTARËVE/-EVE DHE TË DEPUTETËVE/-EVE.

Krahas të gjitha kompetencave të sipërpërmendura të KKZ-së që janë të përcaktuara me ligj, në pjesën që ka të bëjë me përcaktimin e VV, të obligohen KKZ-të që të përcaktojnë VV e aksesueshme për PAK, në mënyrë që përfaqësuesit/-et e KKZ-ve në aktivitetet përgatitore zgjedhore të jenë të obliguar që të përcaktojnë VV e aksesueshme, gjë që do të eliminonte diskriminimin aktual të PAK. Përvojat nga ciklet e mëparshme zgjedhore tregojnë se bashkëpunimi më i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe KKZ-ve është i nevojshëm në procesin e propozimit dhe përcaktimit të VV të aksesueshme, sepse praktika tregon pasivitet në këtë segment.

⁴⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi Nr.105/2020 e datës 29.10.2020.

KKZ TË PËRGJIGJEN KSHZ PËR MOSRESPEKTIMIN E NORMAVE TË PARAPARA ME LIGJ.

KKZ duhet të obligohen që t'i përgjigjen KSHZ-së për çdo mosrespektim të normave të përcaktuara me ligj gjatë punës së tyre.

KSHZ TË MARRË PËRSIPËR KOMPETENCA BRENDA KUADRIT TË MBAJTJES SË TË GJITHA CIKLEVE ZGJEDHORE.

Kompetenca e KSHZ-së, ndër të tjera, duhet të zgjerohet me mundësinë e marrjes përsipër të kompetencave të KKZ-së kur janë në pyetje zgjedhjet lokale, dhe jo vetëm për deputetë/-e dhe për President/-ën.

Marrjen përsipër të kompetencave KSHZ e bën në rast të zgjedhjeve lokale kur KKZ-ja nuk i zhvillon ato në përputhje me normat e përcaktuara me ligj.

TË JEPET PËRPARËSI DEPOLITIZIMIT TË ADMINIS-TRATËS ZGJEDHORE NË TË GJITHA NIVELET DHE TË MUNDËSOHET ZBATIMI I PËRSHTATSHËM I PROCESIT ZGJEDHOR NGA ORGANET ZGJEDHORE.

Në lidhje me përbërjen e KSHZ-së dhe KKZ-ve, duhet të fillohet profesionalizimi i këtyre organeve në mënyrë që të zgjidhen profesionistë në bazë të referencave, të cilët në këtë mënyrë do të monitoronin vazhdimisht procesin zgjedhor, dhe të cilët do të ishin të kualifikuar për punën që kryejnë. Përvoja e mëparshme me ndryshime të shpeshta në përbërjen e komisioneve zgjedhore ka çuar në praktikë të pamundësisë së realizimit të risive në procesin zgjedhor në lidhje me PAK, duke pasur parasysh se komisionet zgjedhore mblidheshin kryesisht vetëm gjatë procesit zgjedhor dhe anëtarët ishin kryesisht të painformuar dhe/ose ata nuk ishin të interesuar (sepse janë të kandiduar nga politika dhe përfaqësojnë interesat e partive që i delegojnë) kur bëhet fjalë për të drejtat e PAK në procesin zgjedhor. Subjekteve politike duhet t'u lihet mundësia e emërimit të anëtarëve në përbërjen e zgjeruar të komisioneve, por pa të drejtë vote.

KSHZ-ja duhet të përbëhet nga profesionistët, ekspertët/-et e procesit zgjedhor që do të zgjidheshin në konkurs publik në Kuvend, ndërsa KKZ-ja do të përbëhej nga 3 anëtarë/-e që duhet të kenë përvojën e nevojshme në procesin zgjedhor. Me qëllim të forcimit të pavarësisë së punës, mandati i anëtarëve/-eve do duhej të jetë 5-7 vjet. Në këtë mënyrë shmanget përputhja e mandatit të anëtarëve/-eve të KSHZ-së me mandatin e deputetëve/-eve.

TË PROFESIONALIZOHET KËSHILLI ZGJEDHOR.

Kur bëhet fjalë për përbërjen e KZ, është e nevojshme të merret parasysh mundësia e (gjysmë)profesionalizimit të tyre në atë mënyrë që të paktën një pjesë e anëtarëve të zgjidheshin nga përfaqësuesit e administratës publike dhe të vetëqeverisjes lokale. Gjithashtu, është i nevojshëm rishikimi i afatit për ndryshimin e anëtarëve të KZ, në 7 ditë para zgjedhjeve, sepse në përputhje me ligjin aktual kjo mundësi ekziston deri në 12 orë para zgjedhjeve, si dhe arsyet e ndryshimit të përbërjes së KZ duhet të vlerësohen nga KKZ-ja duke marrë parasysh arsyet objektive për ndryshimin e tyre.

ANËTARËT/-ET DO TË DETYROHEN TË KANË CERTIFIKATA PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE ZGJEDHORE.

Është e nevojshme që me ligj të parashikohet dhe të obligohet që anëtarët e KZ të ndjekin trajnimet, pas të cilave atyre do t'u lëshohen certifikatat si vërtetim se mund të kryejnë veprime zgjedhore. Në këtë mënyrë ngrihet niveli i njohurive për procesin zgjedhor në përgjithësi, por edhe për të drejtat e PAK. Zgjidhja aktuale jep mundësinë e emërimit të anëtarëve/-eve të KZ që nuk kanë ndjekur trajnimet dhe nuk kanë njohuri dhe aftësi të nevojshme. Parregullsitë më të mëdha në ditën e zgjedhjeve kanë të bëjnë me punën e anëtarëve/-eve të komisioneve zgjedhore.⁴⁷

Gjithashtu, me qëllim të trajnimit uniform, është me nevojë që edukimi i anëtarëve/-eve të KZ të jetë në kompetencë të KSHZ-së në mënyrë që të ofrohet edukim uniform dhe në kohë.

4. PROPOZIMI DHE PËRCAKTIMI I LISTAVE ZGJEDHORE

PAK TË PËRFAQESOHEN NË LISTAT ZGJEDHORE.

Për të nxitur barazinë e PAK, është e nevojshme të parashikohet përfaqësimi i PAK në listat zgjedhore. Kjo duhet të bëhet në atë mënyrë që në listën zgjedhore të përfaqësohen 5% të kandidatëve/-eve me aftësi të kufizuara, duke respektuar normën ekzistuese që i referohet kandidatëve/-eve të gjinisë më pak të përfaqësuar. Pozicioni i kandidatëve/-eve me aftësi të kufizuara në listat zgjedhore do të ishte i tillë që në çdo 10 kandidatë do të ishte të paktën një kandidat me aftësi të kufizuara, deri në plotësimin e kuotës.

LISTA PËRMBLEDHËSE ZGJEDHORE TË PUBLIKOHET NË FAQEN E KSHZ DHE TË JETË E AKSESUESHME NGA TË GJITHË PAK.

Ligji duhet të specifikojë se lista përmbledhëse zgjedhore e përcaktuar të publikohet në faqen e internetit të KSHZ-së dhe se dokumenti i publikuar duhet të krijohet në përputhje me standardet e aksesueshmërisë elektronike.

⁴⁷Shoqata e të Verbërve të Malit të Zi - Raporti përfundimtar për vëzhgimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare të 11 qershorit 2023, <https://ss-cg.org/>

5. PARAQITJA E PARASHTRUESVE/-EVE TË LISTAVE ZGJEDHORE DHE KANDIDATËVE/-EVE NGA LISTAT ZGJEDHORE

APLIKANTËT/-ET PËR LISTË ZGJEDHORE DHE KANDIDATËT/-ET PËR PJESËMARRJE NË ZGJEDHJET DETYROHEN TË NJOFTOJNË QYTETARËT/-ET SIPAS STANDARDEVE TË AKSESUESHMËRISË.

Ligji duhet të parashikojë që parashtruesit/-et e listave zgjedhore dhe kandidatët/-et për pjesëmarrje në zgjedhje, gjatë fushatës zgjedhore, kanë detyrimin për të informuar qytetarët/-et në përputhje me standardet e aksesueshmërisë. Sa më sipër nënkupton titrat e detyrueshme të të gjithë përmbajtjes së videos, përshkrimin e të gjithë grafikëve dhe fotove në postimet në hapësirën e internetit, si dhe përshtatjen e mesazheve drejtuar publikut në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme.

PJESËMARRËSIT/-ET NË FUSHATËN ZGJEDHORE JANË TË DETYRUAR/-A TË MBROJNË TË DREJTAT E NJERIUT DHE DINJITETIN E NJERËZVE.

Gjatë fushatës parazgjedhore vërehet një qasje jo e përshtatshme ndaj PAK dhe janë dëgjuar shprehjet e ndryshme që e cenojnë dinjitetin e PAK. Në këtë drejtim, është e nevojshme të shtohet një normë ligjore që do t'i detyronte pjesëmarrësit/-et në fushatën parazgjedhore të respektojnë të drejtat e njeriut, diversitetin njerëzor dhe dinjitetin e PAK.

6. ZBATIMI I ZGJEDHJEVE

PËRCAKTIMI I VV TË JETË NËN KOMPETENCË TË KKZ ME KONSULTIME TË DETYRUARA ME ORGANIZATAT E PAK.

Është e nevojshme që me ligj të parashikohet se përcaktimi i VV është në kompetencë të KKZ-së. Për më tepër, me rastin e përcaktimit të VV, KKZ-ja të jetë e obliguar të kryejë konsultime me organizatat e PAK që kryejnë aktivitete në fushën e zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet pjesëmarrja e qëllimshme e organizatave të PAK, në përputhje me dispozitat dhe frymën e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

VV TË PLOTËSOJNË STANDARDET E AKSESUESHMËRISË PËR PAR.

VV duhet të plotësojnë të gjitha standardet e aksesueshmërisë për PAK, në përputhje me rregulloret që kanë të bëjnë me rregullimin e hapësirës dhe ndërtimin e objekteve për të mundësuar lëvizjen e pavarur të PAK. Standardet e aksesueshmërisë i referohen:

- Rrethinës: ekzistimi i parkimit të përshtatshëm;
- Qasjes: lartësia e përshtatshme e trotuareve, bordurave, pa pengesa të tjera në formë shtyllash, etj.;
- Zonës së hyrjes: ekzistimi i një rampe me pjerrësi të përshtatshme, gjerësia e derës, gjerësia e korridoreve;
- Brendësisë: shiritat etisoni të vendosur në mënyrë të rregullt, lartësia e kutisë së votimit, rafti i poshtëm në dhomën e votimit, ndriçimi.

VV RREGULLOHET NË MËYNRË QË TË KETË HAPËSIRË TË MJAFTUESHME PËR TË GJITHË.

Në nenin 65 të shtohet se VV duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme që jo vetëm të gjithë anëtarët e KZ, por edhe të gjithë votuesit të kanë qasje të papenguar tek kutitë e votimit dhe materialet e votimit.

PËR PAR TË LEJOHET NËN SHKRIMI I EKSTRAKTEVE NGA LISTA E VOTUESVE ME FAKSIMILE.

Marrjen në dorëzim të fletës së votimit, votuesi/-ja e konfirmon me nënshkrim me dorë të vetë në ekstraktin nga lista e votuesve. Fatkeqësisht, në Mal të Zi ende nuk është miratuar Ligji për përdorimin e faksimileve, që do t'u mundësonte PAK të nënshkruajnë me faksimile. Zgjidhjet aktuale e cenojnë dinjitetin e PAK, sepse anëtarët e KZ ndonjëherë kërkojnë që VI të vendosin një gjurmë gishti në vend të një nënshkrimit me faksimile. Prandaj, është e nevojshme të mundësohet nënshkrimi i PAK me faksimile.

PËR ÇDO VV TË SIGUROHET NJË DHOMË E AKSESUESHME.

Në nenin 72, për çdo vend votimi do të sigurohet një dhomë e aksesueshme ku mund të sigurohet fshehtësia e votimit.

DISPOZITA PËR VOTIM ME NDIHMËN E ASIS- TENTËVE/-EVE TË PËRCAKTOHET DUKE RESPEKTUAR PARIMET E TË DREJTAVE TË NJERIUT, PA THEKSIM TË KARAKTERISTIKAVE PERSONALE TË VOTUESVE/-EVE.

Dispozita në fuqi në paragrafin 1 të nenit 84, duhet të riformulohet në atë mënyrë që të mos theksojë karakteristikat personale apo arsyet për të cilat nevojitet ndihma e një personi tjetër, sepse në rastin e PAK, ndihma e një personi tjetër është e drejta e tyre. Në këtë kuptim, dispozita në fuqi duhet të riformulohet në atë mënyrë që të parashikohet që një votues/-e, që ka nevojë për ndihmën teknike të një personi tjetër për të votuar, të ketë të drejtë ta bëjë këtë me ndihmën e një asistenti/-es që ai/ajo e cakton, dhe që është i/e detyruar të plotësojë fletën e votimit, gjegjësisht të votojë në mënyrën e udhëzuar nga votuesi.

SHABLLONI I VOTIMIT DUHET TË SIGUROJË VOTIM TË FSHEHTË.

Përveç formës dhe pamjes së shabllonit për fletëvotimin, Ligji duhet të përcaktojë ngjyrën dhe materialin nga i cili është bërë shablloni. Që të ketë ngjyrë blu të errët, prej materiali solid me vrima që e mundësojnë fshehtësinë.

Anëtarët/-et e KZ janë të detyruar/-a të vendosin shabllonet për fletëvotimin në tryezën ku ulet KZ, në mënyrë që menjëherë t'ia dorëzojnë VI modelin e votimit me fletëvotim. Anëtarët/-et e KZ janë të obliguar që fletëvotimin ta fusin në shabllon, në mënyrë që në vrima të shihen numrat e listave zgjedhore.

INFORMACIONET, NE DITËN E ZGJEDHJEVE, NË VV, TË JENË NE FORMAT TË AKSESUESHËM.

Me ligjit është e nevojshme të specifikohet që në kohën e votimit, lista e përgjithshme zgjedhore me emrat e listave zgjedhore dhe emrat e kandidatëve/-eve duhet të vendoset në VV në mënyrë të tillë që skaji i sipërm i listës nuk i kalon 160 cm. Përmbajtja e listës duhet të printohet me një nga fontet më të përshtatshme (Arial, Calibri, Tahoma, Verdana, Times New Roman) me një font të zmadhuar, që nuk duhet të jetë nën 18, me një hapësirë më të madhe midis rreshtave, si dhe në alfabetin Braille.

7.PËRCAKTIMI DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE

PROCESVERBALI I PUNËS SË KZ DUHET TË JETË NË FORMATIN DIXHITAL TË AKSESUESHËM.

Duke marrë në konsideratë që pas përfundimit të votimit, KZ vazhdojnë me përcaktimin e rezultateve të votimit për VV përkatës⁴⁸, dhe pastaj përgatisin procesverbalin e punës së KZ, rekomandohet që procesverbali të jetë në formatin dixhital të aksesueshëm, në mënyrë që të jetë në dispozicion të të gjithë anëtarëve/-eve apo vëzhguesve/-eve.

RAPORTET E KKZ TË JENË NË FORMAT DIXHITAL TË AKSESUESHËM.

Rekomandohet që raportet e KKZ-së për rezultatet e votimit për zgjedhjen e deputetëve/-eve dhe këshilltarëve/-eve, që i dorëzohen KSHZ-së, të jenë në format të aksesueshëm dixhital.

Duke marrë në konsideratë se KKZ-të e dorëzojnë raportin me procesverbal të punës së tyre pas ditës së zgjedhjeve, rekomandohet që këto raporte të jenë në një format dixhital të aksesueshëm.

FORMULARET PËR KUNDËRSHTIME TË JENË NË FORMAT DIXHITAL TË AKSESUESHËM.

Ligji duhet të parashikojë detyrimin që formularët për kundërshtime të jenë në format dixhital të aksesueshëm, duke qenë se PAK nuk kanë pasur mundësi të kundërshtimit deri më tani pikërisht për mungesën e tij, gjë që i diskriminonte në krahasim me qytetarët/-et e tjerë.

REZULTATET E ZGJEDHJEVE TË PUBLIKOHEN NË FORMATE TË AKSESUESHME.

Rezultatet e përkohshme dhe përfundimtare të zgjedhjeve duhet të publikohen në formate të aksesueshme për PAK: formati dixhital, formati audio, alfabeti Braille, formati i zmadhuar, gjuhë e lehtë për t'u kuptuar.

⁴⁸ Neni 89 i Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve.

8. MBROJTJA E TË DREJTËS SË VOTËS

TË DETYROHEN AUTORITETET DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR KRYERJEN E ZGJEDHJEVE TË BËJNË TË GJITHA NJOFTIMET TË AKSESUESHME PËR PAK.

Është e nevojshme që ligji të parashikojë detyrimin që organet dhe institucionet përgjegjëse për kryerjen e zgjedhjeve, të cilat janë të detyruara t'i informojnë votuesit/-et gjatë procesit zgjedhor për të drejtat e tyre të votës dhe mënyrën e mbrojtjes së këtyre të drejtave (sipas nenit 106 të ligjit në fuqi), të bëjnë këtë në kohën e duhur dhe në një format që është i aksesueshëm për PAK⁴⁹.

Gjithashtu, institucionet kompetente duhet të obligohen që të përshtatin manifestet e tyre zgjedhore dhe programore dhe informacionet e tjera të rëndësishme për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të votës, si dhe prezantimet në internet, në formate të aksesueshme për PAK.

KUNDËRSHTIMI DHE PËRGJIGJA PËR TË DUHET TË JETË NË FORMAT TË AKSESUESHËM.

Është e nevojshme të parashikohet me ligj që kundërshtimi që çdo votues/-e, kandidat/-e apo parashtrues/-e të listës zgjedhore ka të drejtë ta paraqesë pranë komisionit kompetent zgjedhor për shkak të cenimit të së drejtës së votës gjatë zgjedhjeve, të jetë në formë të aksesueshme për PAK⁵⁰. Gjithashtu, kundërshtimi i dorëzuar në KSHZ kundër vendimit, veprimit ose mosveprimit të KKZ-së duhet të jetë në një format të aksesueshëm për PAK. Vendimi që merr komisioni zgjedhor brenda 24 orëve nga data e marrjes së kundërshtimit, duhet t'i dorëzohet parashtruesit/-es së kundërshtimit në një format të aksesueshëm.

9. VËZHGUESIT/-ET E ZGJEDHJEVE

FORMULARI I APLIKIMIT TË JETË NË FORMAT TË AKSESUESHËM.

Me ligj duhet të parashikohet detyrimi që formulari i aplikimit që organizatat joqeveritare vendore të interesuara për monitorimin e zgjedhjeve ia dorëzojnë KSHZ-së duhet të jenë në një format të aksesueshëm, si dhe që autorizimet zyrtare ose vendimet me të cilat eventualisht refuzohet lëshimi i autorizimit duhet të jenë të aksesueshme për PAK. I njëjti rekomandim duhet të jetë edhe për plotësimin e formularit nga organizatat ndërkombëtare të monitorimit të zgjedhjeve, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Punëve të Jashtme, që pastaj e lëshon kartën e identifikimit (të jetë në një format të aksesueshëm).

⁴⁹Në bazë të nenit 106 të Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, organet përgjegjëse për zhvillimin e zgjedhjeve janë të obliguara që gjatë procesit zgjedhor t'i informojnë votuesit për të drejtat e tyre të votës dhe mënyrën e mbrojtjes së këtyre të drejtave.

⁵⁰Sipas nenit 107, çdo zgjedhës, kandidat dhe parashtrues i listës zgjedhore ka të drejtë të paraqesë ankesë në komisionin kompetent zgjedhor për shkak të shkeljes së të drejtës së votës gjatë zgjedhjeve.

10. DISPOZITAT PENALE

TË PARASHIKOHEN DISPOZITAT PENALE PËR SHKELJE TË STANDARDEVE TË AKSESUESHMËRISË.

Me gjobë të dënohet personi juridik për kundërvajtje, nëse:

1. Mohon, kufizon ose vështirëson PAK në VV ku ata janë të regjistruar në listën e votuesve, në mënyrën dhe formën që ata zgjedhin (në mënyrë të pavarur, me ndihmën e një asistenti, me ndihmën e një shablloni të fletëvotimit);
2. Nuk e mundëson votimin e PAK përmes letrës.

PËRFUNDIM

Procesi i reformës gjithëpërfshirëse zgjedhore është i nevojshëm në Mal të Zi. Pas formimit së legjislaturës së re të Kuvendit, duhet me prioritet të fillojmë ndryshimet e reformës zgjedhore dhe të hartohet Ligji i ri, që do të përfshijë të gjitha mësimet e nxjerra nga periudha e kaluar.

Bazuar në praktikën dhe përvojën e deritanishme, janë krijuar rekomandimet që ndodhen para jush, që synojnë të mundësojnë pjesëmarrjen e barabartë të PAK në jetën politike dhe publike, përmes arritjes së një shkalle më të madhe të aksesueshmërisë së procesit zgjedhor, si dhe mundësinë që PAK të votojnë dhe të jenë të zgjedhur.

Në bazë të tyre, SHVMZ do të përpiqet të ndikojë për të arritur qëllimin e dëshiruar, për të siguruar pjesëmarrjen e qëllimshme të organizatave të PAK në procesin e reformës zgjedhore dhe për të eliminuar çdo formë diskriminimi ndaj BSI.

Prandaj, ftojmë edhe një herë të gjitha institucionet/organizatat që në bashkëpunim me Shoqatën dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile të zbatojnë në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme rekomandimet e lartpërmendura në kuadër të reformës zgjedhore për realizimin e të gjitha të drejtave të PAK që janë të garantuara me Kushtetutë.

PËR SHOQATËN E TË VERBËRVE TË MALIT TË ZI

Shoqata e të Verbërve e Malit të Zi (SHVMZ) është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse, e cila mbledh rreth 1000 njerëz me pamurit plotësisht dhe pjesërisht të dëmtuar, që janë anëtarë të tetë organizatave lokale të të verbërve. Organizatat vendore të të verbërve e mbulojnë territorin e të gjitha komunave në shtetin tonë. Shoqata është themeluar më 11 prill 1947 në Cetinë, ndërsa selia e tanishme është në Podgoricë. Për shtatë dekada e gjysmë, që nga krijimi i saj, Shoqata ka ndërmarrë nisma të shumta legjislative, që kanë synuar përmirësimin, mbrojtjen dhe zbatimin e vazhdueshëm të një game të gjerë të të drejtave të personave me të pamurit e dëmtuar, si dhe zhvillimin e llojeve të ndryshme të programeve dhe shërbimeve që nxisin ngritjen e nivelit të ndërgjegjësisimit të komunitetit më të gjerë shoqëror, por edhe të vetë personave me të pamurit e dëmtuar për nevojat, mundësitë, potencialin, lëvizjen dhe jetesën e pavarur, arsimimin dhe punësimin, të drejtën për një pozicion të barabartë dhe dinjitoz në shoqëri, të drejtat elektorale etj.

Vizioni i SHVMZ është që personat me të pamurit e dëmtuar të fuqizohen dhe të përfshihen në shoqëri.

Misioni i SHVMZ është përfshirja e personave me të pamurit e dëmtuar përmes inkurajimit dhe zbatimit të aktiviteteve që nxjerrin në pah aftësitë e tyre dhe forcojnë personalitetin e tyre.

Më shumë rreth Shoqatës së të Verbërve të Malit të Zi mund të lexoni në faqen e internetit <https://ss-cg.org/>

ANËTARËTE GRUPIT TË PUNËS PËR ZHVILLIMIN E REKOMANDIMEVE PËR AVANCIMIN E LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR LIDHUR ME PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

1. Goran Macanoviq, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së të Verbërve të Malit të Zi;
2. Darko Brajoviq, këshilltar kombëtar i programit për demokratizim, Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – OSBE në Mal të Zi;
3. Katarina Bigoviq Kulliq, ndihmësdrejtoreshë e Shoqatës së të Verbërve të Malit të Zi;
4. Marina Vujaçiq, drejtoreshë ekzekutive e Shoqatës së të Rinjve me Aftësi të Kufizuara të Malit të Zi;
5. Nikolla Mugosha, kryetar i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve;
6. Nikolleta Gjukanoviq, politikologe dhe profesore e asociuar në Universitetin Donja Gorica;
7. Nikollina Miliq, punonjëse sociale në Shoqatën e të Verbërve të Malit të Zi.

Rekomandimet janë krijuar përmes projektit Unë zgjedhi të zgjedhi, që zbatohet nga Shoqata e të Verbërve të Malit të Zi. Projekti mbështetet nga Qendra për Edukim Qytetar (Centar za građansko obrazovanje – CGO) në kuadër të programit “OSHC në Mal të Zi – nga shërbimet bazë deri tek formulimi i politikave - M’BASE” që financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Ministria e Administratës Publike.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Shoqatës së të Verbërve të Malit të Zi dhe nuk pasqyron në mënyrë të domosdoshme pikëpamjet e CGO, Bashkimit Evropian ose Ministrisë së Administratës Publike.



Ovaj projekat finansira
Evropska unija



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education



